

BE-ja për përfshirjen në tregun e punës (EU4LMI)**Duration:** 18.12.2023 - 17.12.2026**Countries:**
Albania**EU contribution:** € 2 700 000**Total budget:** € 3 000 000**Implementer:**

United Nations Development Programme (UNDP), Arbetsformedlingen (Sweden – Public Employment Office), Albanian Disability Rights Foundation

Website(s): undp.org/albania/projects/eu-labour-market-inclusion-eu4lmi**Project description:**

Projekti “BE-ja për përfshirjen në tregun e punës” mbështet shërbime të ndryshme komunitare dhe të kujdesit social, si dhe modele të masave aktive të tregut të punës dhe të praktikave gjithëpërfshirëse në arsimin profesional për grupet në rrezik. Kjo iniciativë, e zbatuar nga UNDP Albania në partneritet me Shërbimin Publik Suedez të Punësimit (Arbetsförmedlingen) dhe Fondacionin Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (ADRF), forcon qëndrueshmërinë e tregut të punës përmes qasjeve të integruara që ndërthurin:

- zhvillimin e aftësive

- promovimin e punësimit dhe të kujdesit social.

Projekti forcon kapacitetet e këshilltarëve të punësimit, punonjësve socialë, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional, punëdhënësve dhe shoqërisë civile, përmes mjeteve dhe instrumenteve për shërbime të integruara të standardizuara, mësimi përmes kolegëve dhe Komuniteteve të Praktikës.


Projekti ofron mbështetje financiare për organizatat e shoqërisë civile përmes këshillimit intensiv për punësim, trajnimeve për zhvillimin e aftësive bazë, si dhe ofrimit të shërbimeve të punësimit të mbështetur për personat me aftësi të kufizuara. Ai përmirëson aksesueshmërinë e zyrave të punës dhe forcon shërbimet e integruara mes aktorëve lokalë për punëkërkuesit në situata të cënueshme. Përmes monitorimit, vlerësimit dhe mësimi, projekti dokumenton rezultatet dhe promovon qëndrueshmërinë. Ndërhyrja ndjek një qasje të orientuar te njeriu dhe të bazuar në të drejtat

Expected results:

- Një ekosistem funksional, i ndërtuar me sukses, i aktorëve të tregut të punës, përmes katër Komuniteteve Rajonale të Praktikës, duke angazhuar mbi 270 profesionistë të vijës së parë dhe duke nxitur qasje të integruara të menaxhimit të rasteve që lidhin punësimin, shërbimet sociale dhe zhvillimin e aftësive.

- Pronësia institucionale është rritur ndjeshëm, veçanërisht brenda AKPA së (NAES). Duke u bazuar në praktikën më të mirë të Shërbimit Publik Suedez të Punësimit dhe mbështetjen e specializuar të ADRF së, programi ka mbështetur AKPA në përshtatjen dhe institucionalizimin e mjeteve, metodologjive dhe standardeve të shërbimit të përshtatura për kërkuesit e punës në situata të cënueshme, me fokus të veçantë te personat me aftësi të kufizuara. Kjo përfshin zhvillimin e qasjeve të standardizuara të këshillimit, metodologjive të punësimit të mbështetur, manualeve dhe udhëzuesve për akomodim të arsyeshëm në vendin e punës, si dhe udhëzime praktike që forcojnë cilësinë, koherencën dhe gjithëpërfshirjen e shërbimeve të punësimit në të gjithë vendin.

- Në nivel përfituesish, projekti ka sjellë rezultate të matshme aktivizimi: 1522 kërkues pune në situata të cënueshme janë përfshirë në këshillim intensiv, trajnime bazë të aftësive (lexim shkrim, matematikë dhe aftësi digjitale) dhe punësim të mbështetur e zhvillim aftësish për personat me aftësi të kufizuara, me një pjesë të konsiderueshme që përfundojnë programet dhe kalojnë në punësim, trajnim të mëtejshëm ose masa të tjera aktivizimi. Mekanizmi i granteve është treguar efektiv në pilotimin e modeleve të shkallëzueshme, duke zgjeruar mbulimin në të gjitha 19

**Social media:**<https://eu4lmi.al/Portal>